




Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT
Prizren, 20.02.2017

**Këshilli për Trashëgimi Kulturore
i Qendrës Historike të Prizrenit**

REKOMANDIM

Investitori, **Ismet Shabani**, me banim në rrugën, "Farkatarëve" nr. 19, me numrin e lëndës: 04-353-59, me të cilën ka kërkuar prej Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor leje për renovimin e kulmit në ngastrën kadastrale me numër 2146 dhe 2145-0 ZK-Prizren.

Këshilli pas shqyrtimit të lëndës dhe daljes në terren konstaton se, lënda ka gabime teknike nga ana e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe, projektit ideor i mungon përshkrimi teknik. Prandaj, lënda kthehet për plotësim në DUPH.

Rekomandimet e këshillit janë;

1. Të përmirsohet gabimi teknik, në kërkesën e DUPH shkruan "renovim" kurse në projektin ideor të dorëzuar shkruan "ndërrim i konstruksionit të kulmit".
2. Të plotësohet projekti ideor me përshkrimin teknik.


Arsyetim

Kërkesa e parashtruar nga investitori për ndërrimin e konstruksionit të kulmit, i përket zonës së Qendrës Historike të Prizrenit. Duke u bazuar në ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, Këshilli ka vërejtje ndaj kërkesës së parashtruar. Prandaj, Këshilli kërkon që të plotësohen të gjitha rekomandimet. Nëse veprohet ndryshe, atëherë investitori do të përballet me masa ligjore.

Anëtarët e këshillit që ishin të pranishëm;

1. Arbnor Morina / Anëtar / Kryetar
2. Igballka Rama / Anëtare / Nënkyetare
3. Artnet Haskuka / Anëtare
4. Svetlana Hadzic / Anëtare
5. Faridin Shala / Anëtar
6. Marin Përgjokaj / Anëtar

KTK, Prizren


Arbnor Morina, Kryetar.